



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2019

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion

ORGANIZATËS _____, SHKODËR

Në vijim të kërkesës suaj për informacion administruar pranë nesh me Nr.10640 Prot., datë 20.06.2019, ju informojmë si më poshtë:

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- Aktivitetet e realizuara nga Bashkia Shkoder për ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore gjatë periudhës Janar – Qershor 2019?

Për riorganizimin dhe funksionimin e sistemit të referimit për viktimat e dhunës në familje është hartuar marrëveshja e bashkëpunimit, dhe janë planifikuar aktivitete në zbatim të kësaj marrëveshje. Gjatë periudhës janar-qershor 2019 janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas kalendarit të paracaktuar, në bashkëpunim me organizatat.

Gjatë periudhës janar-qershor 2019 janë organizuar 8 aktivitete sensibilizuese, informuese, 2 tryeza diskutimi dhe një prezantim raporti mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri

- Numri i personave të përfshirë në aktivitete? Me kë (Target groups) janë zhvilluar aktivitete?

Në aktivitetet e organizuara kanë marrë pjesë grupe target të ndryshme të komunitetit, si të rinjtë, gratë, vajzat dhe djemtë e Bashkisë Shkodër. Nr.i pjesëmarrësve ka qenë rreth 216 persona.

- Sa është buxheti në dispozicion të aktiviteteve ndërgjegjësuese në lidhje me dhunën me bazë gjinore, për periudhën Janar – Dhjetor 2019?

Buxheti në dispozicion të aktiviteteve ndërgjegjësuese në lidhje me dhunën me bazë gjinore, për periudhën janar- dhjetor 2019 është i ndarë në disa zëra:

1. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. (400 mijë lekë)
2. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore. (200 mijë lekë)
3. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi (150 mijë lekë)

Tabela 1. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizuar nga:
1	26 shkurt 2019	Qendra Rinore Atelie	Workshop “Street Art”, në kuadër të projektit “Arti kundër dhunës” Ekspoze e artit të rrugës, historia, tipare, teknika	Bashkia Shkodër Arte Foundation Gruaja tëk gruaja
2	27 shkurt 2019	Qendra Rinore Atelie	Workshop “Street Art”, në kuadër të projektit “Arti kundër dhunës” Diskutim i project-ideve të të rinjve për realizime grafiti në qytetin e Shkodrës	Bashkia Shkodër Arte Foundation Gruaja tëk gruaja
3	28 shkurt 2019	Qendra Rinore Atelie	Workshop “Street Art”, në kuadër të projektit “Arti kundër dhunës” Diskutim përfundimtar dhe përzgjedhja e ideve që do të realizohen	Bashkia Shkodër Arte Foundation Gruaja tëk gruaja
4	4 mars 2019	Qendra Komunitare “Për Familjen” Nr.3	Pse duhet të shqetësohem nga pabarazia gjinore?	Bashkia Shkodër Gruaja tek Gruaja
5	4 mars 2019	Qendra Rinore Atelie	Cinema gender “Roma”	Bashkia Shkodër Gruaja tek Gruaja
6	6 mars 2019	Qendra Komunitare Multifunkionale “Për Familjen”	Aktivitet sensibilizues me komunitetin e lagjes nr. 4, mbi rolin e gruas në familje	Bashkia Shkodër
7	7 mars 2019	Qendra Komunitare “Për Familjen” Rrethina	Seancë informues me temë: Nëse jam viktimë e dhunës kujt t’i drejtohem?	Bashkia Shkodër Gruaja tek Gruaja
8	8 mars	Pedonale “Kolë	Marshim paqësor #MeTy	Bashkia Shkodër

	2019	Idromeno''		Gruaja tek Gruaja
9	17 prill 2019	Salla OSBE-s, Bashkia Shkodër	Takim konsultues për raportin mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri	Bashkia Shkodër IDRA UN UN Eomen
10	22 maj 2019	Salla OSBE-s, Bashkia Shkodër	Prezantimi i raportit mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri	Bashkia Shkodër IDRA UN UN Eomen
11	27 maj 2019	Salla OSBE-s, Bashkia Shkodër	Tryezë diskutimi: Analiza e funksionimit të mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës (MKR). Progreset, problematikat, nevojat dhe praktikat e mira.	Bashkia Shkodër UNDP Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
12	31 maj 2019	Hotel Rozafa	Tryezë diskutimi : Stop dhunës me bazë gjinore! Niveli i zbatimit të objektivit të 3-të të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2016-2020	Gender Alliance for Development Center

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- Kush është koordinatori vendor i mekanizmit të referimit për rastet e dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Shkodër? Çfarë detyrash të tjera kryen? Kontrata me Bashkinë?

Përkohësisht koordinatori vendor i mekanizmit të referimit për rastet e dhunës me bazë gjinore është znj. Lorena Bardeli, e cila është njëkohësisht specialiste e sektorit të planifikimit strategjik, standarteve dhe monitorimit për shërbimet sociale dhe shëndetin publik.

- Sa trajnime ka marrë koordinatori – cilat?

Gjatë periudhës janar-qershor, nuk janë zhvilluar trajnime.

- Sa është buxheti i bashkisë vetëm për dhunën në familje? (Paga + Aktivitete+ Materiale)

Buxheti direkt i Bashkisë për dhunën në familje për vitin 2019 është 11 000 mijë lekë. Ndërsa buxheti indirekt përfshin edhe kohën e punës së specialistëve dhe të funksionimit të qendra Komunitare “Për Familjen” të cilat operojnë në territorin e Bashkisë së Shkodrës.

- Mekanizmi i referimit te rasteve të dhunës në familje, si funksionon, sa raste ka trajtuar në periudhën Janar – Qershor 2019, sa raste kanë qenë të suksesshme?

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, “Për Vetqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”(i ndryshuar), i ndryshuar me Ligjin Nr.47/2018, neni 8, pika 8 e tij; si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, Bashkia e Shkodrës gjatë vitit 2017, ka koordinuar dhe nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për riorganizimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga të gjitha institucionet publike që veprojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës me rastet e dhunës në familje dhe gjithashtu organizatat e shoqërisë civile që janë aktive dhe veprojnë në territor me këtë target grup. Bashkëpunimi midis këtyre institucioneve dhe organizatave përgjatë periudhës janar-qershor 2019 ka qenë shumë i mirë. Të gjithë aktorët i janë përgjigjur në kohë nevojës për veprim dhe menaxhim të rasteve. ETN mblihet ad-hoc, në varësi të rasteve të dhunës në familje dhe problematikave që paraqet çdo rast konkret, ose brenda 24-48 orëve ose brenda javës kur është identifikuar rasti. Ky ekip mblihet me kërkesën e institucionit, pjesë e mekanizmit, i cili ka identifikuar rastin. (psh; policia, organizata, Bashkia, qendrat komunitare). Në momentin që paraqitet një rast dhune, bëhet vlerësimi fillestar për të parë nivelin e riskut në të cilin ndodhet viktimja. Më pas bëhet vlerësimi i detajuar, sipas nevojave që paraqet rasti, mblihet ETN, ndahen rolet e përgjegjësitë. Pas vlerësimit të nevojave të çdo rasti, hartohet plani i punës dhe për çdo shërbim të specializuar vlerësohen mundësitë dhe kapacitetet fillimisht nga institucionet, pjesë e mekanizmit dhe në rast se këto institucione nuk i ofrojnë, kërkohet mbështetja nga partnerë të ndryshëm privatë apo publikë. Çdo rast, që trajtohet nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe Qendrat Komunitare “Për Familjen”, pjesë e kësaj drejtorie, trajtohet në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës.

- Numri i raporteve të përmuajshme që ndan koordinatori me anëtarët e MKR – dokumenta zyrtare?

Koordinatorja ndan sipas rastit raporte të caktuara për menaxhimin e rasteve dhe monitorimin e UM.

- Numri i grave te dhunuar qe kanë përfituar ndihmë ekonomike gjatë periudhës Janar – Qershor 2019.

Numri i grave të dhunuara që kanë përfituar ndihmë ekonomike gjatë periudhës Janar – Qershor 2019 është 5.

Tabela 2. Numri i mbledhjeve të ETN-së për periudhën Janar – Qershor 2019 në Bashkinë Shkodër

Viti	Mbledhjet e ETN
2019	Mbledhja e parë –17 prill 2019 Takim konsultues për raportin mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri
2019	Mbledhja e dytë – 22 maj 2019 Prezantimi i raportit mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri
2019	Mbledhja e tretë – 27 maj 2019 Tryezë diskutimi: Analiza e funksionimit të mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës (MKR). Progreset, problematikat, nevojat dhe praktikat e mira.
2019	Mbledhja e katërt– 31 maj 2019 Tryezë diskutimi: Stop dhunës me bazë gjinore! Niveli i zbatimit të objektivit të 3-të të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2016-2020

Burimi: Bashkia Shkodër

Tabela 3. Numri i mbledhjeve të KD-së sipas viteve në Bashkinë Shkodër

Për periudhën janar-qershor 2019 nuk janë realizuar mbledhje të KD-së.

Viti	Mbledhjet e KD
2019	Mbledhja e parë – Çfarë u trajtua?
2019	Mbledhja e dytë – Çfarë?

Burimi: Burimi Bashkia Shkodër

Tabela e Këshillit Drejtues

Institucioni	Emër Mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Voltana Ademi
Drejtoria e Policisë	Niko Brahimaj
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Arbër Çela
Prokuroria e Rrethit	Ylli Pjetërgjokaj
Zyra Arsimore Shkodër	Kadri Ymeraj

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër	Lindita Haxhija
Zyra e Përmbartimit	Enderson Memçaj
Prefektura	Çesk Millja
Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit	Rozafa Zmijani
Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional	Meri Markici
Hapat e Lehtë	Denada Shpuza
Gruaja te gruaja	Majlinda Angoni
Shërbimi i Provës	Frida Dashi
Drejtoria e Shërbimit Social	Valbona Tula
Zyra për djem dhe burra	Endrit Uligaj
Komisariati i Policisë Shkodër	Lorenc Meta

Tabela 4. ETN-ja e Bashkisë Shkodër viti 2019

Institucioni	Emër Mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Lorena Bardeli
Drejtoria e Policisë	Dede Gazulli
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Blenda Behri
Zyra Arsimore Shkodër	Suela Domnori
Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Shkodër	Stela Niklekaj
Prefektura	Fluzela Zaja
Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional	Eleonora Asllani
Hapat e Lehtë	Denada Shpuza
Gruaja te gruaja	Atila Uligaj
Shërbimi i Provës	Nandi Samarxhiu
Drejtoria e Shërbimit Social	Valbona Tula
Zyra për djem dhe burra	Endrit Uligaj

- Kush i plotëson UM dhe UMM në Shkodër?

UM dhe UMM plotësohen nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër.

- Në vitin 2019 sa UM/UMM janë plotësuar nga bashkia? Sa nga organizatat?

Për periudhën janar-qershor 2019 Bashkia Shkodër nuk ka plotësuar UM dhe UMM.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Voltana Ademi